



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

Shkoder, me 24.09.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje karburant

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

6,933,561 (Gjashte milion e nenteqind e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e gjashtedhjetë e një) leke pa TVSH Fondi limit është perlllogaritur nga Sektori I Planifikim -raportim bazuar në publikimin e cmimeve nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UK Shkoder ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

- GAZOIL 10 PPM

Të dhënat teknike i referohen standardit **SSH EN 590:2022** “Lëndë djegëse e lëngët për automjete-Gazoil(diesel).

Nr	Treguesit cilësor	Njësia e matjes	Normat e lejuara	
			minimale	maksimale
1.	Numri i cetanit	panjësi	51	
2.	Indeksi i cetanit	panjësi	46	
3.	Densiteti në 15 °C	kg/m ³	820	845
4.	Hidrokarburët aromatikë policiklikë	% (m/m)	-	8
5.	Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10
6.	Pika e flakërimit	°C	55	
7.	Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01
8.	Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vlerësim	klasa 1	
9.	Përmbajtja e esterit metilik të acidit yndyror (FAME)	% (v/v)	-	7
10.	Viskoziteti kinematik në 40 °C	(cSt)	2	4,50
11.	Përmbajtja e ujit	% (m/m)	-	0.02
12.	Lubriciteti, në 60 ⁰ C	µm	-	460
13.	Mbetje karboni (në 10% mbetje distilimi)	% (m/m)		0.3
14.	Distilimi			

a.	Distilati që vlon deri në 250°C	% (V/V)		65
b.	Distilati që vlon deri në 350 °C	% (V/V)	85	
c.	95 % (v/v) distilon në	°C		360

• **BENZINË PA PLUMB**

Të dhënat teknike të Benzines i referohen standardit SSH EN 228:2012+A1:2017 “Lëndët djegëse për automjete - Benzinë pa plumb.

	Treguesi cilësor	Njësia matjese	Normat e lejuara	
			minimale	maksimale
1.	Numri oktanit kerkimor RON	panjësi	95	
2.	Numri oktanit motorrik MON	panjësi	85	
3.	Densiteti në 15 °C °	kg/m ³	720	775
4.	Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10
5.	Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	renditje	klasa 1	
6.	Tensioni i avujve të thatë ekuivalent	kPa	45	100
7.	Distilimi			
a.	Distilon deri 70°C	%(v/v)	20	48
b.	Distilon deri 100°C	%(v/v)	46	71
c.	Distilon deri 150°C	%(v/v)	75	
a.	Pika finale e distilimit	°C		210
b.	Mbetja e distilimit	%(v/v)		2
8.	Përmbajtja e tipit të hidrokarburit			
a.	Olefinat	%(v/v)		18

b.	Aromantiket	%(v/v)		35
9.	Përmbajtja e benzenit	%(v/v)		1
10.	Përmbajtja e oksigjenit	%(m/m)		2.7
11.	Përmbajtja e komponimeve oksigjenore			
a.	Methanol (alkooli metilik)	%(v/v)		3
b.	Etanol (alkool etilik)	%(v/v)		5

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përfshiruar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2022,2023,2024 me një vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit të këtij prokurimi. **Kjo Kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.**

2.1.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancin vjetor, për vitin financiar 2022, 2023, 2024 ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në përputhje me Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3: “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të jetë e madhe se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës...”bazuar në nenin 43 të VKM-në Nr. 285 datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore kërkohej bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30. 01. 2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Bilancet për tre vitet e fundit janë kërkuara bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe shërben për të njohur gjendjen financiare të operatorëve ekonomik ofertues.

2.1 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë prej 20% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave

të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vertetuar eksperiencën e operatorëve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses

2.2.2 Subjekti ofertues duhet të disponojë të paktën 1(një) stacion të tregtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Shkoder, të pajisura me dokumentacionin si më poshtë:

- Stacionet duhet të vertetohen me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (Çertifikate pronësie ose kontrate noteriale qeraje).
- Stacionet detyrimisht duhen të jenë të pajisur me Leje mjedisore të tipit C leshuar nga QKL, Vertetim teknik leshuar nga ISHTI ose Organet e Miratimit të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK).
- Çertifikate e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjeve me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë licencë, ”Për tregtim karburante me pakicë”, të leshuar nga Bashkia Shkoder që korrespondon me vendodhjen e Stacionit.

Argumentimi: : Kërkesat e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Vendosja e këtyre kriterëve nga ana e AK-së është bërë duke patur parasysh vendodhjen e zyrave qendrore të Shoqërisë dhe rendesisë së shërbimeve që ofron brenda kornizës ligjore në fuqi lidhur me dokumentacionin përkatës për stacionet e shitjes me pakicë të karburantit. Është gjykuar si domosdoshmeri që operatorët ekonomik ofertues të posedojnë minimumi një stacion të furnizimit me karburant, duke plotësuar të gjitha përcaktimet ligjore dhe n/ligjore për funksionimin e tij, si psh. Akti i pronësisë ose kontrate noteriale me qera, leje mjedisore tipit C, mbrojtje kundër zjarrit MNZ, police sigurimi, licensë për ushtrim aktiviteti.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vertetim të leshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislationit Shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilesisë për vitin 2024.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Per te ushtruar tregtimin e karburanteve eshte e domosdoshme qe operatori ekonomik ofertues te tregtoj karburant sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar

- 2.2.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese Flete/Raport analize të lëshuar nga ISHTI ose nga një laborator i çertifikuar në Republikën e Shqipërisë e cila duhet të jetë lëshuar brenda 30 diteve nga data e hapjes së ofertave per (Gazoil, benzine).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Per te ushtruar tregtimin e karburanteve eshte e domosdoshme qe operatori ekonomik ofertues te tregtoj karburant sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar, me qellim vertetimin e standartit:

- **GAZOIL STANDARD SSH EN 590:2022**
- **BENZINË STANDARD S.SH.EN 228:2012+A1:2017**

- 2.2.5 Subjekti ofertues duhet te zoteroje (ne pronesi apo me qera) 1 (nje) mjet autobot. Autoboti te jete i paisura me Leje Qarkullimi, Kolaudimi (SGS), police sigurimi, certifikate per transportin e mallrave te rrezikshme dhe pasaporta e mjetit lidhur me kapacitetin mbajtes.Ne rastin kur autoboti eshte me qera subjekti ofertues duhet te paraqese kontraten noteriale te qerase.

(Kerkesa 2.3.5 do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentat e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Per te ushtruar tregtimin e karburanteve eshte e domosdoshme qe operatori ekonomik ofertues te disponojne edhe autobot per transportimin, pasi per arsye te disa makinerive te renda , mund te nevojtit edhe furnizim me autobot prane UK Shkoder sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar ne perputhje edhe me nenin 40/5 te VKM nr. 285, date 19.05.2021

- 2.2.6 Subjekti ofertues duhet të paraqesë deklaratat si mëposhte:

- I. Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë ne qytetin e Shkodres me karte elektronike te personalizuar me targon e çdo automjeti të autoritetit kontraktor ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor ne momentin e lidhjes se kontrates. *(Deklarate nga subjekti ofetues.)*

- II. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike. *(Deklarate nga subjekti ofetues.)*
- III. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasine e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targonë e mjetit ose botë në llogarë, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Kartat elektronike duhet të jenë pa skadencë dhe të konsumueshëm edhe gjatë vitit 2026. *(Deklarate nga subjekti ofetues)*
- IV. Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, sipas adresave të kërkuara nga autoriteti kontraktor .
- V. Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 "Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme" operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike
- VI. Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasise të karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targonë e mjetit si dhe administrimi i sasise të karburanteve të kryhet nga vete Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: : Kërkesat e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për të ushtruar tregtimin e karburanteve është e domosdoshme që operatori ekonomik ofertues të tregtoj karburant sipas kushteve të mësipërme bazuar në VKM nr. 561, datë 29.07.2016 në përputhje edhe me nenin 40/8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021

Njesia e Prokurimit.